VENDIM
Nr. 268, datë 29.3.2017

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 748, DATË 11.6.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA MBI PAGË PËR PUNONJËSIT E PERSONELIT AKADEMIK NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", dhe të ligjit nr.130/2016, "Për buxhetin e vitit 2017", me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr. 1, "Struktura dhe nivelet e pagave sipas kategorive të vendeve të punës, për nëpunësit e institucioneve publike të arsimit të lartë", që përmendet në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) Në pikën 7, pagesa për çdo orë mësimore mbi normën e miratuar me dispozitë, e përcaktuar në shkronjat "a", "b", "c", "ç" dhe "d", të kësaj pike, ndryshon, si më poshtë vijon:

"a) Kur janë në kategorinë "Profesor", përfitojnë 1 320 (një mijë e treqind e njëzet) lekë për çdo orë 60-minutëshe;

Kur janë në kategorinë "Profesor i Asociuar", përfitojnë 1 210 (një mijë e dyqind e dhjetë) lekë për çdo orë 60-minutëshe;

Kur janë në kategorinë "Docent", përfitojnë 1 100 (një mijë e njëqind) lekë për çdo orë 60-minutëshe;

ç) Kur janë "Lektor i parë", përfitojnë 880 (tetëqind e tetëdhjetë) lekë për çdo orë 60-minutëshe;

d) Kur janë "Lektor", përfitojnë 660 (gjashtë-qind e gjashtëdhjetë) lekë për çdo orë 60-minutëshe.".

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2017, të përballohen nga fondet e politikës për rritjen e pagave, të përcaktuara në ligjin nr.130/2016, "Për buxhetin e vitit 2017".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 mars 2017.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Lidhja nr. 1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E PERSONELIT AKADEMIK,

NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË

Nr. rendor	Pozicioni	Paga
1	Rektor (titullar institucioni)	139800
2	Zëvendësrektor, nga kategoria "Profesor"	132200
3	Zëvendësrektor, nga kategoria "Docent"/"Doktor"	130500
4	Dekan nga kategoria "Profesor"	132200
	Dekan nga kategoria "Docent"/"Doktor"	130500
5	Zëvendësdekan, nga kategoria "Profesor"	121000
6	Zëvendësdekan, nga kategoria "Docent"/"Doktor"	106700
7	Përgjegjës i njësisë bazë nga kategoria "Profesor"	123800
8	Përgjegjës i njësisë bazë nga kategoria "Docent"/"Doktor"	106700
9	Titullar i grupit mësimor-kërkimor nga kategoria "Profesor"	123800
10	Titullar i grupit mësimor-kërkimor nga kategoria "Docent"/"Doktor"	106700
11	Profesor	121000
12	Profesor i asociuar	105200
13	Docent (Doktor)	95800
14	Docent (Master)	91800
15	Lektor i parë/Kërkues i parë	90300
16	Lektor/Kërkues	73400